



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1845/6 Prot

Tiranë, më 23.12.2022

VENDIM

Nr.63, datë 23.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. (në vijim “ankuesja”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesat nr. 1836 Prot., dhe nr. 1845 Prot., datë 26.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Drejtësisë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se ankesat lidhen me të njëjtat fakte, bazë ligjore dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 04.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë katër - mujorit të parë të vitit 2022, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, si vijon:

1. Nr. 54, datë 26.1.2022 “Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës”;

2. Nr. 94, datë 09.2.2022 “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”;
3. Nr. 208, datë 06.4.2022 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës për përfitimin e mbrojtjes së veçantë të garantuar nga shteti për përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave” ;
4. Nr. 209, datë 06.4.2022 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve”;
5. Nr. 280, datë 29.4.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe kritereve të detajuara për kushtet teknike, sigurinë, përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”.

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 10.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë periudhës Maj - Shtator 2022, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, si vijon:

1. Nr. 303, datë 11.5.2022 “Për përcaktimin e kushteve, afateve dhe procedurës për ofrimin e shërbimeve nga sekretaria e regjistrin elektronik, nëpërmjet portalit ‘e-Albania’, kushteve dhe mënyrave të pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik dhe procedurave për ndryshimin e tyre, kushteve të sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrave të vërtetimit të dokumenteve elektronike, të lëshuara nga sekretaria e regjistrin elektronik, të kërkesave e teknologjisë së zbatueshme për realizimin e tyre, si dhe procedurave të njoftimeve publike, të realizuara nga sekretaria e regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse”;
2. Nr. 304, datë 11.5.2022 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2022”;
3. Nr. 305, datë 11.5.2022 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për rastet dhe mënyrën e përdorimit të armëve, të ndryshme nga armët e zjarrit, si dhe të pajisjeve kufizuese nga Policia e Burgjeve”;
4. Nr. 403, datë 09.06.2022 “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Burgjeve”;
5. Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”;
6. Nr. 549, datë 29.7.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 260, datë 5.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të Policisë së Burgjeve”;
7. Nr. 550, datë 29.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.296, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës dhe ngjyrës së shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve”;

8. Nr. 590, datë 7.9.2022 “Për mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”.

Autoriteti Publik, lidhur me kërkesat për informacion, nëpërmjet e-mail-it datë 11.10.2022, ka argumentuar se dokumentacioni i kërkuar nuk disponohet pranë Ministrisë së Drejtësisë, por pranë Këshillit të Ministrave. Në këto kushte e ka dërguar kërkesën për trajtim pranë koordinatorit për të drejtën e informimit në Kryeministri.

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, me e-mail-in datë 11.10.2022, ka saktësuar kërkesat për informacion duke shpjeguar se: “Informacioni i kërkuar, disponohet nga Ministria e Drejtësisë, sepse është pikërisht ky institucion që e dërgon relacionin e projekt VKM-së në Këshillin e Ministrave (pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave).

Në vijim, Autoriteti Publik me e-mail-in datë 17.10.2022, ka kthyer përgjigje me arsyetimin se: “Sipas nenit 17, të ligjit 9000/2003, Ministri i Drejtësisë dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave, është i detyruar të respektojë vendimet e marra në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe çdo vlerësim, debat apo raportim duhet të mbeten konfidenciale. Në këtë kuptim, mendimi i dhënë nga çdo anëtar i Këshillit të Ministrave është pjesë e pandashme e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve dhe është baza e diskutimeve, vlerësimeve dhe debateve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Gjatë kësaj mbledhjeje ministrat e linjës, si dhe Ministri i Drejtësisë marrin pjesë, shprehen duke bazuar në mendimin që kanë dhënë paraprakisht mbi projektvendimin gjatë procesit të hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve.

Pra, mendimet që japin ministratë e linjës për projektaktin, si dhe shpjegimi që Ministri i Drejtësisë jep në relacionin shpjegues të çdo projektakti normativ, për marrjen ose jo parasysh të vërejtjeve dhe të mendimeve të ministrave ose të institucioneve të tjera të interesuara, është pjesë e procesit vendimmarrës të Këshillit të Ministrave, i cili nuk mund të bëhet publik për shkak të kufizimeve të vendosura nga neni 17 i ligjit 9000/2003.

Në përputhje me këtë dispozitë, mendimet e dhëna nga ministratë e linjës dhe shpjegimi i dhënë nga Ministria e Drejtësisë për marrjen ose jo parasysh të tyre, janë pjesë e pandashme e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të çdo mbledhjeje të Këshillit të Ministrave. Rrjedhimisht, ky detyrim, i lexuar bashkërisht me kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” e përjashton Ministrinë e Drejtësisë nga detyrimi për të vendosur në dispozicion relacionet shpjeguese të projektakteve të paraqitura për shqyrtim e miratim nga Ministri i Drejtësisë”.

Ndërkohë, ankuesja pas përgjigjes së sipërcituar pretendon se: “...Relacioni është një dokument zyrtar që shoqëron projekt-VKM-në. Si i tillë, ai mban stemën e institucionit propozues dhe nënshkrimin e drejtuesit të tij. Mes të tjerash, në të përfshihen mendimet dhe vërejtjet institucionale të ministrave dhe institucioneve të interesuara, si edhe shpjegimet për marrjen ose jo parasysh të tyre. Ky dokument zyrtar nuk rezulton të jetë subjekt i ndonjë kufizimi të ndonjë ligji të posaçëm, përfshirë këtu edhe ligjin 9000/2003.

*Gjithashtu, dokumenti nuk rezulton t'i nënshtrohet asnjërit prej kufizimeve të ligjit për të drejtën e informimit.*

*Kufizimet e nenit 17 të ligjit 9000/2003 parashikojnë detyrimin e anëtarit të Këshillit të Ministrave për besueshmëri dhe solidaritet. Sipas kësaj dispozite, anëtari i Këshillit të Ministrave duhet të ruajë konfidencialitetin e vlerësimeve, debateve apo raportimeve në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Ky kufizim është i lidhur ngushtësisht me qenien anëtar i Këshillit të Ministrave dhe mbulon vetëm vlerësimet, debatet apo raportimet e shprehura personalisht nga vetë anëtari apo anëtarë të tjerë gjatë mbledhjes së Këshillit të Ministrave.*

*Dokumentet zyrtare u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që përcaktohen specifikisht në ligjin për të drejtën e informimit ose në ligje të tjera të posaçme. Kufizimet e lidhura me personin (qenien anëtar i Këshillit të Ministrave) nuk mund të aplikohen me analogji edhe për dokumentet institucionale që mbajnë nënshkrimin e tij.*

*Relacioni përmban mendime dhe vërejtje me karakter institucional dhe jo personal. Vënia në dispozicion e dokumentit zyrtar “relacion” nuk cenon në asnjë mënyrë konfidencialitetin e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, pasi relacioni nuk pasqyron vlerësimet, debatet apo raportimet e anëtarëve të shprehura gjatë mbledhjes. Ai pasqyron vetëm mendimet dhe vërejtjet institucionale/zyrtare, pjesë e procesit të “konsultimit” të projekt-VKM-së, përpara se të dërgohet dhe të jetë pjesë e diskutimeve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.*

*Duhet theksuar gjithashtu se Ministria e Drejtësisë, ka plotësuar kërkesa të mëparshme për vënie në dispozicion të relacioneve të projekt-VKM-ve, si edhe të mendimeve që Ministria e Drejtësisë ka shprehur për to. Mendimet e shprehura, në çdo rast janë të karakterit institucional.*

*Ndryshimi i praktikës institucionale është i pashpjegueshëm dhe i pabazuar në ligj.*

*Rrjedhimisht, relacioni përfundimtar që shoqëron projekt-VKM-në, si një dokument zyrtar, që nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi ligjor, përbën një informacion publik, i cili duhet vënë në dispozicion sipas kërkesës për informim në ushtrim të një të drejte kushtetuese. Refuzimi për vënien në dispozicion të këtij informacioni është një akt i paligjshëm, i cili shkel të drejtën kushtetuese për informim të çdo qytetari”.*

Në vijim, ankuesja kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin

*dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Zyra e Komisionerit, me shkresat nr. 1836/1 prot., dhe nr. 1845/1 Prot., datë 02.11.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 5775/1 Prot., datë 09.11.2022, regjistruar pranë Zyres së Komisionerit me nr. 1845/2 Prot., datë 11.11.2022, ka kthyer përgjigje duke refuzuar vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar me argumentin se: “...Në bazë të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, në mbledhjet e Këshillit të Ministrave shqyrtohen dhe miratohen projektaktet e propozuara nga ministrat përkatës dhe në raste të veçanta dhe me të pakta, mund të përfshihen çështje të tjera që nuk lidhen me to.

*Sipas nenit 16 të ligjit nr. 9000/2003, gjatë mbledhjes, ministrat kanë të drejtë të shfaqin mendimin e tyre mbi projektaktet që janë dërguar paraprakisht për mendim sipas nenit 24 të ligjit. Më tej, pika 62 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, parashikon se: “Drejtuesi i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministrat propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre.”.*

*Në këtë kuptim, mendimi i dhënë nga Ministri i Drejtësisë dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave, i cili pasqyrohet në relacionin shpjegues të projektaktit, është pjesë e pandashme e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Gjatë mbledhjes, anëtari merr pjesë duke u shprehur, bazuar në mendimin që ka dhënë paraprakisht mbi projektvendimin gjatë procesit të hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve. Në rastin konkret, nuk bëhet fjalë thjesht dhe vetëm për një dokument të zakonshëm të përpiluar, por për një dokument i cili është në funksion të një procesi i cili kalon në disa hallka dhe pjesë përbërëse thelbësore e hallkës kryesore, mbledhjes së Këshillit të Ministrave.*

*Në lidhje me karakterin e mendimeve të paraqitura në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sillet në vëmendje anëtari i Këshillit të Ministrave është pjesë e mbledhjes së tij pikërisht për shkak të cilësisë së tij si një organ publik. Sipas nenit 95/1 të Kushtetutës “Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat”, nga ku rezulton se Këshilli i Ministrave është një organ kolegjal është i përbërë nga mjaft organe individuale.*

*Për nga natyra, struktura dhe mënyra e marrjes së vendimeve, ministri është një organ monokratik/individual, ku një person të vetëm i janë veshur të gjitha kompetencat dhe cilësitë e një organi publik. Si i tillë, anëtari i Këshillit të Ministrave nuk merr pjesë në mbledhje si një person fizik i çfarëdoshëm, por si një organ publik më vete. Për shkak të natyrës së këtij institucioni dhe mënyrës së marrjes së vendimeve, çdo akt i nënshkruar*

nga Ministri është akt i cili reflekton nga njëra anë bindjen dhe mendimin e tij dhe, nga ana tjetër, përgjegjësinë që ai mbart për përmbushjen e detyrimeve Kushtetuta dhe ligji i kanë ngarkuar. Në këto kushte, për shkak se procesi i hartimit, të akteve nga Këshilli i Ministrave është një proces i një natyre të veçantë, ku përfshihet edhe detyrimi për të ruajtur konfidencialitetin e mbledhjes, në këtë rast, dokumentet institucionale që mbajnë nënshkrimin e tij shprehin pikërisht mendimin e tij.

Nëse relacioni do të shihej si një dokument i shkëputur nga mbledhja e Këshillit të Ministrave, publikimi i relacionit, do të konsiderohej si shprehje mospajtimi me vendimin e marrë nga Këshilli i Ministrave, pavarësisht se më pas, qëndrimet dakordësohen. Pra, publikimi i relacionit shpjegues dhe rrjedhimisht edhe i mendimit në një situatë të tillë do sillte si pasojë shkeljen e detyrimit sipas pikës 1, të nenit 17 të ligjit nr. 9000/2003. Në vijim të argumenteve duke qenë se mendimet e dhëna gjatë fazës së hartimit dhe bashkërendimit të projektakteve janë baza mbi të cilën zhvillohen vlerësimet, debate dhe raportimet, publikimi i tyre sjellin si pasojë shkeljen e parimit të konfidencialitetit të tyre sipas pikës 2, të po të njëjtit nen.

Pikat 1 dhe 2 të nenit 17 të ligjit nr. 9000/2003 nuk përmbajnë parashikime të veçuara nga njëra tjetra, por janë plotësuese dhe në harmoni me qëllim garantimin e parimeve të besueshmërisë dhe solidarësisë me qëllim mbajtjen e një qëndrimi të përbashkët të anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Në të kundërt, nëse mendimet anëtarëve të Këshillit të Ministrave mbi projektaktet, të cilat pasqyrohen në relacion, publikohen përmes publikimit të këtij të fundit, atëherë është e nevojshme që neni 17 i ligjit të vendose detyrime mbi përkrahjen e vendimmarrjes dhe ruajtjen e konfidencialitetit të vlerësimeve dhe debateve gjatë mbledhjes për shkak se tashmë mendimi është publikuar dhe në mënyre indirekte edhe vlerësimet e debatet janë të njohura nga publiku.

Në lidhje me pretendimin se vendosja në dispozicion e relacionit nuk çënon konfidencialitetin e mbledhjes, sillet në vëmendje se pasqyrimi i mendimeve të anëtarëve të KM dhe shpjegimi mbi pranimin ose refuzimin e komenteve, i shërben pikërisht debateve në mbledhjen e KM. Përmes kësaj forme, të gjithë anëtarët e KM kanë mundësi të njihen me mendimet e anëtarëve të tjerë, dhe në fund të krijojnë bindjen e tyre që e shprehin përmes votës.

Ligji nr. 119/2014 përbën ligjin kuadër që parashikon të drejtën e informimit të qytetarëve, duke parashikuar edhe kufizimet përkatëse. Megjithatë, në rastin konkret ndodhemi përballë një konflikti të normave pasi ligji i posaçëm, nr. 9000/2003, parashikon dhënien e relacioneve/mendimeve të ministrave dhe sipas argumenteve të sipërcituara edhe konfidencialitetin e tyre, ndërsa ligji nr. 119/2014 parashikon bërjen publike të çdo informacioni që disponohet nga autoriteti publik.

Në këtë rast, nevojitet ti referohemi vendimit nr. 20 datë 20.04.2021, të Gjykatës Kushtetuese që për rastet e konfliktit të normave, është shprehur se: "ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër, (lex superior derogat inferiori). Ndërsa në rastin e normave me të njëjtën fuqi

*juridike, Gjykata thekson se zbatohen parimet, sipas të cilave norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme (lex specialis derogat generali) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë kapërparësi nga norma e mëparshme”.*

*Në kushtet kur këto ligje kanë fuqi të ndryshme juridike pasi ligji nr. 9000/2003 është miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit në bazë të shkronjes "a", të pikës 2, të nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, normat e tij kanë epërsi ndaj ligjit nr. 119/2014”.*

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”,* si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,* me shkresën nr. 1845/5 Prot., datë 02.12.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seancë e cila u zhvillua me datë 07.12.2022 në mungesë të ankueses, e cila me e-mail-in datë 07.12.2022, bëri me dije mbi pamundësinë për pjesëmarrjen fizike të saj.

Ankuesja, gjithashtu, sipas kërkesës së Zyrës së Komisionerit, vendosi në dispozicion parashtrimet me shkrim mbi të cilat i qëndroi ankesave dhe mbështeti vijimin e ankimeve.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoriteti Publik, prezent në seancën dëgjimore, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në shkresës nr. 5775/1 Prot., datë 09.11.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1845/2 Prot., datë 11.11.2022.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se argumentet e dhëna nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Drejtësisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Ndërkohë, në nenin 1 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,* përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të ministrit, të institucioneve në varësi të tyre, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, marrëdhëniet ndërmjet tyre, si dhe aktet nënligjore, që nxjerrin këto organe”.* Gjithashtu, vendimi nr. 584, datë 28.8.2003 *“Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”,* i ndryshuar, në Kreun I, parashikon se: *“Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me: a) përgatitjen dhe paraqitjen e*

*projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre ne Këshillin e Ministrave; b) organizimin e mbledhjeve te Këshillit te Ministrave...”*

Në këto kushte, neni 17 i ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cituar nga Autoriteti Publik, i cili parashikon se: *“1. Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t’i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Ata duhet të mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi dhe të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë ose jo në mbledhje, ose nëse kanë votuar pro ose kundër tyre. 2. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale”,* i referohet konkretisht organizimit dhe funksionimit të mbledhjeve të anëtarëve të Këshillit të Ministrave, lidhur me diskutimet/vlerësimet dhe jo akteve të cilat prodhohen/përpilohen nga autoritetet publike në kuadër të detyrës së tyre funksionale.

Në pikën 1 të nenit 25 të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *“1. Propozimet e projektakteve, që paraqiten për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, duhet të përmbajnë projektaktin, relacionin, mendimet ose vërejtjet e ministrive ose te institucioneve te interesuara...”*

Gjithashtu, në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, në Kreun VI “Paraqitja e projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave”, parashikohet se: *43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 44. Projektakti, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. 45. Propozimet e projekteve shoqërohen me: a) projektaktin e bashkërenduar me ministrinë përkatëse; b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministrinë e interesuara; c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara. Në çdo rast mendimi i Ministrisë të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin; ç) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.”*

Rrjedhimisht, referuar dispozitave të sipërcituara, këto akte, të cilat përpilohen/regjistrohen pranë Autoritetit Publik dhe janë pjesë detyruese që shoqërojnë projektaktin përkatës, përbëjnë informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të LDI, në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nuk jemi përpara konfliktit të normave juridike midis ligjit të posaçëm dhe LDI, sipas argumentit të përdorur nga Autoriteti Publik, pasi këto legjislacione rregullojnë dy fusha veprimtarie të ndryshme.



Në këto kushte, legjislacioni që rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike është LDI, ligj ky i cili parashikon bërjen publike të informacionit që disponohet nga këta të fundit.

Por, edhe nëse ky dokumentacion publik do të kishte aspekte konfidenciale, ashtu si pretendon Autoriteti Publik, në frymën e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, ai duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Konstatohet gjithashtu se, Autoriteti Publik në asnjë moment nuk ka argumentuar apo cituar se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Pasi, është ky nen i cili parashikon mundësinë e kufizimit e të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Theksojmë se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesave nr. 1836 Prot., dhe nr. 1845 Prot datë 26.10.2022 të znj.  
, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 04.10.2022 dhe datë 10.10.2022, duke respektuar

kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 06.01.2023.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23.12.2022.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**